



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2024/0102

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Vedat Poterqoi - Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së (OE) “Al Group PRO” SH.P.K., kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit të “Komuna e Vushtrrisë” në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit “Mbikëqyrja e projekteve kapitale të Komunës së Vushtrrisë” me numër të prokurimit VU644-23-12599-2-1-1, me 22/04/2024, mori:

Vendim

1. **Aprovohet**, si pjesërisht e bazuar ankesa e OE “Al Group PRO” SH.P.K., me nr. 2024/0102, e datës 06/02/2024, kurse vendimi i AK “Komuna e Vushtrrisë” lidhur me aktivitetin e prokurimit “Mbikëqyrja e projekteve kapitale të Komunës së Vushtrrisë” me numër të prokurimit VU644-23-12599-2-1-1, mbetet në fuqi

2. Lejohet të bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 24.11.2023, “Komuna e Vushtrrisë” në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me “Mbikëqyrja e projekteve kapitale të Komunës së Vushtrrisë” me nr. të prokurimit: VU644-23-12599-2-1-1. Ndërsa me datën 22.01.2024 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues ku ka shpërblyer me kontratë OE “Al Engineering SH.P.K.”- Prishtinë

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të **hapur**, lloji i kontratës: - **shërbim**, vlera e parashikuar e kontratës: 250,000.00.

Me 26.01.2024, OE “Al Group PRO” SH.P.K., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Më 30.01.2024, Autoriteti Kontraktues e ka refuzuar kërkesën si të bazuar.

Me 06.02.2024, OSHP ka pranuar ankesën nga OE “Al Group PRO” SH.P.K., me nr. 2024/0102 për lidhur me aktivitetin “Mbikëqyrja e projekteve kapitale të Komunës së Vushtrrisë” me nr. të prokurimit: VU644-23-12599-2-1-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Al Group PRO” SH.P.K., janë parashtruar si në vijim:

Pretendimi 1: “OE ankues pretendon që: “Ne këtë procedurë ne jemi eliminuar me pretendimin që oferta financiare jonë periudhën e validitetit të ofertës është më pak sesa që është kërkuar. Oferta financiare jone ka afate prej 90-ditësh ashtu siç është e rregulluar me ligjin e prokurimit, rregullorja e prokurimit publike nr. 001/2022 për prokurim publik neni 30-Ku Kontratave me vlerë të madhe siç është natyra e kontratës ku ne po paraqesim duhet të ketë minimumi 90 ditë validitet. Ndërsa ky validitet duhet të jete së paku 30ditë më pak sesa sigurimi i tenderit ndërsa në dosjen e tenderit është kërkuar që sigurimi i tenderit të ketë validitet 120 ditë, andaj nuk mund të kërkohet sikurse sigurimi i tenderit dhe validiteti i tenderit me të njëjtën afat kohor 120 ditësh pasi një gjë e tillë është në kundërshtim me Ligjin, Rregulloret dhe Udhëzuesit e prokurimit publik.”

Pretendimi 2: “Pas qasjes ne dokumente zyrtare ne OE te shpallur fitues nga ana juaj ne kemi pare qe ky OE është i papërgjegjshëm pasi qe ne dosjen e tenderit për prezantimin e kontratave te ngjashëm është kërkuar qe te paraqitet Aneksi 6 ne dosjen e tenderit, Ku Operatori Ekonomik ne fjale nuk e ka paraqitur dhe si te tille oferta financiare është dashur qe te shpallet e papërgjegjshme dhe eliminohet nga procedura dhe jo te favorizohet dhe shpallet si i Përgjegjshëm edhe te propozohet për kontratë.”

Pretendimi 3 :“OE i shpallur fitues për këtë procedure gjithashtu nuk ka nënshkruar dhe vulosur aneksin 1 për specifikime teknike në rregullore nr.001/2022 për prokurimin publik Neni19,

Specifikimet Teknike më konkretisht neni 19.11 tregon qartas që specifikimet teknike janë kërkesë obligative, ku Operatori ekonomik i shpallur fitues nuk ka përbushur kërkesën pasi që nuk ka nënshkruar as vulosur Aneksi1- ku janë të paraqitura specifikimet teknike në lidhje me procedurën si të tillë Autoriteti Kontraktues është dashur të shpall të papërgjegjshëm. Pasi që në Aneksin 1 janë të detajizuara edhe punët që do të kryhen ku si të tilla ato janë pjesë e ofertës. Andaj duke u bazuar në Rregullore, OE është dashur të shpallet i Papërgjegjshëm.”

Pretendimi 4: “Qe te kryhet një shërbim i caktuar nga një Person Fizik dhe Person Juridik duhet te lidhet një kontratë, një kontrate pune e cila është e bazuar ne ligjin e punës, OE i shpallur fitues nga ana juaj nuk posedon kontratë te lidhura me inxhinieret sipas ligjit te punës: Në bazë të nenit 10 dhe nenit 11 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës të Republikën e Kosovës, dhe akteve të brendshme të kompanisë (rregullore, statute) palët e kësaj kontrate në bazë të autorizimeve të tyre si subjekte të së drejtës dhe marrëdhënies së punës, lidhin:..”

Pretendimi 5 : “Me rastin e ofertimit OE i shpallur Fitues: PARAMASEN e PARALLOGARIN e kane paraqitur tek AK ne formën PDF. Ku dihet se KRPP qe nga data 01.11.2022 ka dal me njoftim dhe vendim qe AK-të nuk duhet te pranojnë më Paramasa te formës PDF, gjithashtu dhe OE nuk ju lejohet te ngarkojnë më Paramasa te formës PDF , pranohen vetëm ne EXCEL.”

Pretendimi 6 : “GOE P.M.N. SH.P.K.; N.P.N. UNIVERS- MI ne kete procedure te tenderimit, Me rastin e ofertimit OE i P.M.N. SH.P.K.; N.P.N. UNIVERS- MI -PARAMASEN e PARALLOGARIN e kane paraqitur tek AK ne formën PDF. Ku dihet se KRPP qe nga data 01.11.2022 ka dal me njoftim dhe vendim qe AK-të nuk duhet te pranojnë më Paramasa te formës PDF, gjithashtu dhe OE nuk ju lejohet te ngarkojnë më Paramasa te formës PDF , pranohen vetëm ne EXCEL.”

Pretendimi 7 : “Qe te kryhet një shërbim i caktuar nga një Person Fizik dhe Person Juridik duhet te lidhet një kontratë, një kontratë pune e cila është e bazuar ne ligjin e punës, ne këtë procedure Inxhinieri B. ka ofruar kontrate qe nga vitit 2012, ku ne baze te ligjit te punës një kontratë është valide për një afate prej 10vitesh siç e parashikon ky ligj ku nga kjo shihet qe kontrata e prezantuar nga Inxh,B. është kontratë e cila nuk përbush kërkesën.”

Pretendimi 8 : “OE i P.M.N. SH.P.K.; N.P.N. UNIVERS- MI për këtë procedure gjithashtu nuk ka nënshkruar dhe vulosur aneksin 1per specifikime teknike në rregullore nr.001/2022 për prokurimin publik Neni19, Specifikimet Teknike më konkretisht neni19.11 tregon qartas që specifikimet teknike janë kërkesë obligative, ku Operatori ekonomik i shpallur fitues nuk ka përbushur kërkesën pasi që nuk ka nënshkruar as vulosur Aneksi1- ku janë të paraqitura specifikimet teknike në lidhje me procedurën si të tillë Autoriteti Kontraktues është dashur të shpall të papërgjegjshëm. Pasi që në Aneksin 1 janë të detajizuara edhe punët që do të kryhen ku si të tilla ato janë pjesë e ofertës. Andaj duke u bazuar në Rregullore, OE është dashur të shpallet i Papërgjegjshëm.”

Pretendimi 9: “OE i P.M.N. SH.P.K.; N.P.N. UNIVERS- MI pas afateve ligjore te kaluara ne këtë procedure shihet qe nuk janë pale e interesit se përveç se kane ofruar çmime jo normalisht te

ulëta gjithashtu edhe nuk kane parashtruar kërkesë për rishqyrtim.”

Pretendimi 10: “GOE FST Engineering SH.P.K.;Hilmi A. Mulaku B.I.;TAULANT SHPK;STUDIO HAPSIRA SH.P.K., Në këtë procedurë tenderimit të gjithë operatorët ekonomik të kësaj procedure deklaratat nën betim kanë ofruar deklaratën nën betim me gabim pasi që në pjesën e sipërme është me gabime si të tilla është dashur të eliminohen nga procedura dhe jo të shpallen të papërgjegjshëm. Qe të gjithë e kane pa-përmbushur këtë pikë.”

Pretendimi 11: “Që të kryhet një shërbim i caktuar nga një Person Fizik dhe Person Juridik duhet të lidhet një kontratë, një kontratë pune e cila është e bazuar në ligjin e punës, OE i shpallur fitues nga ana juaj nuk posedon kontratat të lidhura me inxhinieret sipas ligjit të punës: Në bazë të nenit 10 dhe nenit 11 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës të Republikën e Kosovës, dhe akteve të brendshme të kompanisë (rregullore, statute) palët e kësaj kontrate në bazë të autorizimeve të tyre si subjekte të së drejtës dhe marrëdhënies së punës, lidhin:... Andaj OE do të duhej që të shpallet i papërgjegjshëm.”

Pretendimi 12: “GOE i FST Engineering SH.P.K.;Hilmi A. Mulaku B.I.;TAULANT SHPK;STUDIO HAPSIRA SH.P.K.,për këtë procedure gjithashtu nuk ka nënshkruar dhe vulosur aneksin 1 për specifikime teknike në rregullore nr.001/2022 për prokurimin publik Neni19, Specifikimet Teknike më konkretisht neni19.11 tregon qartas që specifikimet teknike janë kërkesë obligative, ku Operatori ekonomik i shpallur fitues nuk ka përmbushur kërkesën pasi që nuk ka nënshkruar as vulosur Aneksi1- ku janë të paraqitura specifikimet teknike në lidhje me procedurën si të tillë Autoriteti Kontraktues është dashur të shpall të papërgjegjshëm. Pasi që në Aneksin 1 janë të detajizuara edhe punët që do të kryhen ku si të tilla ato janë pjesë e ofertës. Andaj duke u bazuar në Rregullore, OE është dashur të shpallet i Papërgjegjshëm.”

Pretendimi 13: “GOE i FST Engineering SH.P.K.;Hilmi A. Mulaku B.I.;TAULANT SHPK;STUDIO HAPSIRA SH.P.K., është i papërgjegjshëm pasi që në dosjen e tenderit për prezantimin e kontratave të ngjashëm është kërkuar që të paraqitet Aneksi 6 në dosjen e tenderit, Ku Operatori Ekonomik në fjale nuk e ka paraqitur dhe si të tillë oferta financiare është dashur që të shpallet e papërgjegjshme dhe eliminohet nga procedura dhe jo të favorizohet dhe shpallet si i Përgjegjshëm edhe të propozohet për kontrate. Andaj në bazë të nenit 69-te LPP-se oferta e tilla duhet të refuzohet pasi që lista e prezantuar nuk përmbush kërkesën e autoritetit Kontraktues.”

Pretendimi 14: “Inxhinierja e prezantuar për këtë procedure të tenderit ku është kërkuar që të prezantohet certifikimi me ccna, nuk e posedon një të tilla por vetëm certifikime të tjera që nuk i përgjigjen kërkesës së Autoritetit kontraktues andaj është dashur të shpallet i papërgjegjshëm.”

Pretendimi 15: “GOE i FST Engineering SH.P.K.;Hilmi A. Mulaku B.I.;TAULANT SHPK;STUDIO HAPSIRA SH.P.K., pas afateve ligjore të kaluara në këtë procedure shihet që nuk janë pale të interesit se përveç se kanë ofruar çmime jo normalisht të ulëta gjithashtu edhe nuk kane parashtruar kërkesë për rishqyrtim.”

Pretendimi 16: “Pas qasjes ne dokumente zyrtare ne nuk kemi pranuar nga Autoriteti Kontraktues qe janë kërkuar informata shtese për çmimet e ofertuara pasi qe çmimet e ofertuara nga OE te shpallur përgjegjshëm çmimet e tyre janë qmime te cilat bien ne kundërshtim me ligjin, rregulloren. Prandaj AK është dashur të e zbatojë ligjin për tenderët jo normalisht të ulët dhe duke u bazuar në këto dallime në % kaq të larta nuk është dashur të kërkojë fare sqarime shtesë.”

Duke u referuar pretendimeve si më sipër “Al Group PRO” SH.P.K., konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 7, 59, 61, 64, 69 të LPP-së rregullore 001/2022 nenin 28, 30, 19 Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës të Republikën e Kosovës, -Manual përdorimi për Operatorë Ekonomik V.1.2-Përdorimi i sistemit të prokurimit elektronik-KRPP- - Udhëzues Nr.001/2023 për prokurimi publik 8- Kriteret e përzgjedhjes . Duke propozuar qe te anulohet njoftimi mbi vendimin dhe lënda te kthehet ne rivlerësim.

Përgjigje e AK ne kërkesën për rishqyrtim: Bazuar ne te gjitha te cekurat si me lart ne këtë vendim AK vlerëson se pretendimet e OE ankues janë te pa bazuara, te pa sakta dhe ne kundërshtim me dispozitat ligjore te LPP-se. Përfundimisht AK vlerëson se me rasti e marrjes se vendimit si ai i datës 22.01. 2024 për te rekomanduar për dhënie te kontratës për OE: "AL Group PRO" Sh.p.k. Prishtinë, nuk ka elemente apo prova se janë shkelur dispozitat ligjore te cituara si më lartë ne këtë vendim, me theks te veçantë neni 1 — Qëllimi, neni 6 Ekonomiciteti dhe Eflkasiteti, neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi, neni 56 Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave, neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve, dhe neni 60 Kriteret për Dhënien e Kontratës, nenin 69 Aftësia teknike dhe/ose profesionale, sepse është rekomanduar për dhënie te kontratës OE me tenderin e përgjegjshëm dhe me çmimin me te ulet, ndërsa me asnjë prove nuk është vërtetuar se ndonjë OE është trajtuar Jo-barabartë apo diskriminuar, nuk është vërtetuar se nuk ka pasur transparencë apo konkurrencë nga OE lidhur me këtë aktivitet te prokurimit.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 09.02.2024 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 00102/24, ndërsa me datë 22.02.2024 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2024/0102 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK nuk pajtohet rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtuese, ndërsa OE pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për te vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore ne kuptim te nenit 24 paragrafi 1 te Rregullore së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtrirat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE “Al Group PRO” SH.P.K., - eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2024/0102 ka vlerësuar si në vijim:

Sqarim hyrës: OE ankues është eliminuar nga aktiviteti i prokurimit dhe si palë e pakënaqur ka ngritur pretendime edhe për operatorët e tjerë pjesëmarrës të cilët janë vlerësuar si të pasuksesshëm nga komisioni vlerësues. Për çdo pretendim të ngritur eksperti shqyrtues ka dhënë përgjigje si më poshtë.

Konstatimi 1: “Eksperti shqyrtues në lidhje me pretendimin sa i përket periudhës së vlefshmërisë së tenderit sqaron se, AK në Njoftimin për Kontratë të publikuar, përkatësisht në pikën 3.5 të këtij njoftimi ka përfshirë edhe periudhën e vlefshmërisë së tenderit e cila është 120 ditë, por të njëjtën nuk e ka përfshirë edhe në Dosje të Tenderit. OE ankues duke u bazuar vetëm në DT ka dorëzuar periudhën e vlefshmërisë së tenderit vetëm për 90 ditë nga data finale për dorëzim të tenderëve, e cila nuk është në përputhje me periudhën e vlefshmërisë e cila është kërkuar nga AK përmes Njoftimit për Kontratë. Operatorët ekonomik duhet të përmbushin kërkesat duke u bazuar edhe në Njoftimin për kontratë edhe në Dosje të Tenderit. Është e vërtetë se AK nuk e ka përfshirë këtë periudhë edhe në DT, megjithatë OE ankues është dashur të ofroj vlefshmërinë e tenderit sipas kërkesave të parapara në Njoftimin për kontratë, pa marr parasysh nëse e njëjta periudhë është përfshirë edhe në DT apo jo. Andaj, bazuar në atë çfarë sqaruar më lartë, konsiderojmë që OE ankues në këtë pikë nuk ka përmbushur kërkesat edhe pse në rastin konkret ka pasur edhe pakujdesi nga ana e AK-së, megjithatë OE pjesëmarrës duhet të përmbushin të gjitha kërkesat të cilat janë të përfshira në NjK dhe DT. Ky pretendim vlerësojmë se është pjesërisht i bazuar.”

Konstatimi 2: “OE i rekomanduar ka plotësuar një formë tjetër të kontratave të realizuara sipas kërkesave të DT-së, por jo edhe sipas formës së kërkuar të Aneksi 6, OE ankues në listën e dorëzuar ka përfshirë të gjitha të dhënat e tjera të kërkuara përmes Aneksi 6, përveç pjesës ku deklaroi se- “Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të verifikojë të dhënat e paraqitura në këtë Aneks dhe nëse vërtetohet ndonjë dëshmi e rreme, oferta e tillë do të konsiderohet si një oferte e pa përgjegjshme dhe për shkak të paraqitjes së të dhënave të rreme, do të kërkohej nga Organi Shqyrtues i Prokurimit për të vënë atë në listën e zezë të Operatoreve Ekonomik.” Kjo pjesë e Aneksi 6 nuk është përfshirë në listën e dorëzuar me ofertë nga ana e OE i rekomanduar, i cili bënë që kjo listë sipas ekspertit të mos mund të konsiderohet si dokument i përpiluar sipas kërkesave të DT-së. OE i rekomanduar është dashur të plotësoj Aneksi 6 sipas DT-së, duke shtuar apo hequr rreshta sipas nevojës, duke nënshkruar dhe vulosur të njëjtën formë të kërkuar. Ky pretendim konsiderojmë që është i bazuar.”

Konstatimi 3: “Eksperti sqaron se në Dosje të Tenderit, është i përfshirë edhe Aneksi 1, ku çdo e dhënë dhe çdo pozicion në këtë Aneks është identik me secilën të dhënë dhe secilin pozicion të Paramasës. OE i rekomanduar ka dorëzuar dokumentin 8 të ofertës-para masë, të nënshkruar dhe të vulosur e cila i përmban të gjitha të dhënat dhe është identike me Aneksi 1 dhe çdo pozicion të tij. Duke marr parasysh se mes këtyre dy dokumenteve nuk ka asnjë dallim të vetëm në përmbajtje dhe duke marr parasysh se tek kriteret përkatëse të DT-së nuk është kërkuar që operatorët duhet të dorëzojnë Aneksi 1 të nënshkruar dhe vulosur, ku në rastin konkret do të përbënte dorëzimin e dy dokumenteve të njëjta, vlerësojmë se dokumenti i dorëzuar nga ana e OE i rekomanduar e përmbush edhe kushtin e dorëzimit të Aneksi 1, sepse po e ritheksoj edhe njëherë se çdo pozicion dhe secila e dhënë në këtë dokument është identike me Aneksi 1. Sipas nenit 59 të LPP-së, pika 4, sipas ekspertit ky rast mund të merret si një devijim i vogël, sepse konsiderojmë se nuk është i nevojshëm dorëzimi i dy dokumenteve identike. Në këtë pikë vlerësojmë që ky pretendim është i pabazuar.”

Konstatimi 4: “Në ofertën e dorëzuar nga ana e OE i rekomanduar, për stafin profesional të angazhuar, si dëshmi e këtij stafi në DT është kërkuar që të dorëzohen edhe kontratat e punës me punëdhënësin ose marrëveshje mbi angazhimin për këtë projekt. OE i rekomanduar në ofertën e tij, përveç emërimit të menaxherit të projektit i cila është emëruar me vendim, për të gjithë stafin tjetër të përfshirë në listë, ka dorëzuar kontratat tre vjeçare të punës të lidhura me këta inxhinier, por eksperti pasqyron që këto kontrata janë lidhur në vitin 2022 që do të thotë që do të përfundojnë në vitin 2025, ndërsa aktiviteti i prokurimit ka kohëzgjatja tre vjeçare përkatësisht deri në vitin 2027. Në këtë pikë, vlerësoj se OE i rekomanduar është dashur të dorëzoj marrëveshje për angazhim të stafit apo kontrata me një periudhë e cila përfshinë edhe realizimin e të gjithë projektit. Megjithatë konsideroj që operatori ekonomik ka përmbushur kriterin e kontratave të punës me punëdhënësin dhe të njëjtat janë dorëzuar edhe në ofertë. Ky pretendim është pjesërisht i bazuar.”

Konstatimi 5: “Eksperti sqaron se sa i përket pretendimit se para masa nga ana e operatorëve pjesëmarrës duhet të dorëzohet vetëm në formatin Excel dhe jo PDF nuk qëndron. Asnjë dispozitë ligjore, as me rregullore dhe as me udhëzues nuk specifikohet një kufizim i tillë. Po ashtu në ueb faqe nuk ekziston asnjë interpretim i KRPP-së përmes të cilit kërkohet nga Autoritetet Kontraktuese që të pranohen vetëm formatet Excel të para masave. Duhet të kemi të qartë se rastet kur para masa duhet nënshkruar dhe vulosur nga ana e operatorëve ekonomik, është normale se e njëjta nuk mund të dorëzohet më në formatin e njëjtë por duhet të skanohet dhe të bashkëngjitet edhe si pdf. Për të sqaruar më tutje, tabela e plotësuar është e të njëjtit format-excel, e shtypur në të njëjtin format(nga Excel) e nënshkruar, vulosur dhe e skanuar. Ky pretendim sipas ekspertit është i pabazuar.”

Konstatimi 6: “Këtë pretendim e kemi sqaruar në përgjigjen e pretendimit numër 5, e njëjta përgjigje vlenë edhe për rastin konkret.”

Konstatimi 7: “Sa i përket këtij pretendimi, eksperti pasqyron që për inxhinierin në fjalë është bashkëngjitur kontrata e punës e cila është lidhur mes stafit në fjalë dhe operatorit ekonomik në

vitin 2012, kontratë e cila tek pjesa e kohëzgjatjes e ka të shkruar qartë se kjo kontratë po lidhet për kohë të pacaktuar. Në rastet e tilla kontrata shkëputet vetëm nëse këtë e kërkon njëra nga palët e përfshira në këtë kontratë apo të dyja palët njëkohësisht, përndryshe kontrata me kohëzgjatje të pacaktuar zgjatë deri në momentin e shkëputjes së saj për arsye të caktuara. Në këtë pikë vlerësojmë se OE e ka përmbushur kriterin sipas DT-së. Ky pretendim konsiderojmë që është i pabazuar.”

Konstatimi 8: “OE ankues ka dorëzuar para masën e cila përmban të gjitha detajet identike me Aneksi 1, paramasa e dorëzuar është nënshkruar dhe vulosur edhe nga ana e operatorit ekonomik. Duke marr parasysh se çdo rresht dhe kolonë dhe çdo e dhënë tjetër e Aneksi 1 është identike me paramasën, atëherë eksperti vlerëson se nuk ka qenë e nevojshme që nga secili operator të dorëzohen dy dokumente të njëjta, kështu që vlerësojmë se në rastin konkret operatorët të cilën kanë dorëzuar të gjitha pozicionet e plotësuara sipas Aneksit 1, të nënshkruara dhe të vulosura janë në rregull. Për më tepër as në DT nuk ka pasur ndonjë kërkesë të veçantë nga ana e AK-së, se operatorët pjesëmarrës duhet të dorëzojnë si të veçantë edhe Aneksi 1. Pra, nuk ka ndonjë të dhënë e cila është pjesë e Aneksi 1 dhe nuk është përfshirë edhe në para masë, andaj dorëzimi i dy dokumenteve identike nuk ka qenë kërkesë e DT-së dhe konsiderojmë që nuk janë të nevojshme. Ky pretendim është i pabazuar.”

Konstatimi 9: “Eksperti shqyrtues sqaron që kërkesa për rishqyrtim nuk është e detyrueshme për operatorët ekonomik pjesëmarrës në një aktivitet prokurimi, kjo kërkesë parashtrohet nga të gjithë ata të cilët vlerësojnë se AK nuk ka bërë vlerësim të drejtë në përputhje me dispozitat ligjore dhe në rastin kur nuk janë të kënaqur as me përgjigjen e marr në këtë kërkesë, atëherë vazhdojnë më tutje duke parashtruar ankesë në OSHP apo zgjedhin të pajtohen me vendimin e AK-së.”

Konstatimi 10: “Eksperti sqaron se duke u bazuar në pretendimin e ngritur është e vërtetë që grupi i OE në fjalë tek Deklarata nën betim, tek pjesa fillestare e deklaratës nuk kanë shënuar emrin e operatorit ekonomik, mirëpo, tek pjesa e tabelës është e shënuar çdo e dhënë tjetër, përfshirë emrin e operatorit ekonomik, adresën e plotë, emrin e përfaqësuesit, pozitën, datën si dhe të njëjtat janë të nënshkruara dhe vulosura nga ana e operatorëve në grupin pjesëmarrës. Si të tilla, këto deklarata shihen qartë se kujt i takojnë dhe nënshkrimi bashkë me vulën vërtetojnë këtë deklaratë nën betim, mos shënimi i emrit edhe në pjesën e sipërme mund të merret si devijim i vogël sipas nenit 59 të LPP-së, sepse përfundimisht secila deklaratë shihet qartë se kujt i takon dhe mos përmbushja e kushteve të kësaj deklarate ka sanksionimet e njëjta ashtu siç janë paraparë me këtë deklaratë.”

Konstatimi 11: “Sa i përket GOE FST Engineering SHPK, Hilmi A. Mulaku B.I, Taulant SHPK dhe Studio Hapësira SHPK, eksperti sqaron se nuk është i vërtetë pretendimi se të njëjtit nuk kanë ofruar kontrata pune për inxhinierët e angazhuar. Në pikën 6.0 të ofertës së GOE, ndodhen të gjitha marrëveshjet për angazhim të inxhinierëve në këtë aktivitet të prokurimit dhe të njëjtat përmbajnë të gjitha të dhënat e nevojshme të cilat duhe ti ketë një kontratë pune apo marrëveshje angazhimi, duke përfshirë të dhënat personale, të drejtat, detyrimet, pagesat e afatet kohore.

Përveç inxhinierit D.K -Inxhinier i ndërtimtarisë, për të cilin është ofruar kontratë e punës. Andaj, ky pretendim konsiderojmë që është i pabazuar.”

Konstatimi 12: “Eksperti shqyrtues për këtë pretendim ka dhënë përgjigje në pretendimin numër 8.”

Konstatimi 13: “Bazuar në pretendimin e ngritur, eksperti shqyrtues ka analizuar të gjitha dokumentet e dorëzuar në ofertë nga ana e GOE- FST Engineering &..., pas analizimit të dokumenteve të dorëzuara në ofertë është parë se vetëm njëri nga operatorët pjesëmarrës në këtë grup ka dorëzuar Aneksi 6 sipas formës së njëjtë të kërkuar me DT (pika 5.3 e ofertës) dhe jo edhe dy anëtarët e tjerë të grupit, në këtë pikë njësoj si anëtari i tretë i grupit edhe dy anëtarët e tjerë është dashur të plotësojnë Aneksin 6 sipas kërkesave në DT, andaj konsiderojmë që ky pretendim është i bazuar dhe se GOE pjesëmarrës nuk kanë plotësuar kriteret sipas dosjes.”

Konstatimi 14: “Bazuar në këtë pretendim eksperti sqaron se inxhinierja e GOE pjesëmarrës ka dorëzuar një certifikatë Cisco CCNP, kjo certifikatë ndryshe nga certifikata CCNA e kërkuar në DT, konsiderohet si nivel më i avancuar i cili tregon një nivel më të thellë njohurish krahasuar me certifikatën CCNA. Ndryshe në DT kërkesë ka qenë që operatorët të ofrojnë certifikatë CCNA për inxhinierin Softuerik, mirëpo duke marr parasysh që certifikata e ofruar është e nivelit më të avancuar krahasuar me certifikatën e kërkuar dhe gjithashtu ngjashmëritë me këto dy certifikata janë të shumta, sipas ekspertit një certifikatë e tillë më e avancuar plotëson më shumë kriteret sesa ato të kërkuara nga vet autoriteti. Andaj, vlerësoj që ky pretendim është i pabazuar.”

Konstatimi 15: “Eksperti shqyrtues edhe për këtë rast ka dhënë përgjigje në pretendimin me numër 9.”

Konstatimi 16: “AK ka dërguar kërkesë për sqarim në lidhje me tenderin jo-normalisht të ulët tek operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë. AK ka pranuar përgjigje nga ana e OE i rekomanduar, i cila ka sqaruar se si do të realizoj këtë kontratë me çmimet e ofertuara. Sipas dispozitave ligjore- neni 61 i LPP-së, pas sqarimeve shtesë të kërkuara, AK është bindur me këto sqarime të marra nga ana e operatorit ekonomik andaj edhe ka proceduar tutje me rekomandimin e tij për kontratë. Ky pretendim, vlerësojmë që është i pabazuar.”

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues në kuptim të neneve 1, 6 dhe 7 të LPP, ka vlerësuar duke rekomanduar për kontratë OE i cili është i përgjegjshëm me çmimin më të lirë. Paneli shqyrtues vlerëson se eksperti shqyrtues i ka trajtuar pretendimet ankimore të operatorit ekonomik ankues dhe se arsyetimi i tij/saj në raportin e ekspertit gjenë mbështetje të pjesërishme nga ana e këtij Paneli Shqyrtues. Arsyetimi apo konstatimi i cili nuk gjenë mbështetje të ana e këtij paneli shqyrtues është për përgjigjen në pretendimin e dytë dhe të katërt të radhitur në raportin e ekspertizës të datës 22.02.2024.

Mirëpo duhet theksuar faktin ligjor se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Panelin Shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të

shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit, prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, raportin e ekspertit dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjyqimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të Ligjit të Prokurimit Publik.

Ankuesi ka atakuar eliminimin e tij/saj, ku sipas AK oferta e ankuesit ka periudhën e validitetit të ofertës më pak sesa që është kërkuar. Eksperti shqyrtues në lidhje me pretendimin sa i përket periudhës së vlefshmërisë së tenderit sqaron se, AK në Njoftimin për Kontratë të publikuar, përkatësisht në pikën 3.5 të këtij njoftimi ka përfshirë edhe periudhën e vlefshmërisë së tenderit e cila është 120 ditë, por të njëjtën nuk e ka përfshirë edhe në Dosje të Tenderit. OE ankues duke u bazuar vetëm në DT ka dorëzuar periudhën e vlefshmërisë së tenderit vetëm për 90 ditë nga data finale për dorëzim të tenderëve, e cila nuk është në përputhje me periudhën e vlefshmërisë e cila është kërkuar nga AK përmes Njoftimit për Kontratë. Operatorët ekonomik duhet të përmbushin kërkesat duke u bazuar edhe në Njoftimin për kontratë edhe në Dosje të Tenderit. Është e vërtetë se AK nuk e ka përfshirë këtë periudhë edhe në DT, megjithatë OE ankues është dashur të ofroj vlefshmërinë e tenderit sipas kërkesave të parapara në Njoftimin për kontratë, pa marr parasysh nëse e njëjta periudhë është përfshirë edhe në DT apo jo. Andaj, bazuar në atë çfarë sqaruar më lartë, konsiderojmë që OE ankues në këtë pikë nuk ka përmbushur kërkesat edhe pse në rastin konkret ka pasur edhe pakujdesi nga ana e AK-së, megjithatë OE pjesëmarrës duhet të përmbushin të gjitha kërkesat të cilat janë të përfshira në NjK dhe DT. Paneli Shqyrtues vlerëson se eksperti shqyrtues në mënyrë profesionale dhe objektive e ka vlerësuar këtë pretendim dhe ankuesi ka qenë dashtë që validitetin e ofertës ta sjell konform kërkesës së AK tek Njoftimi për kontratës, pra prej 120 ditëve, e jo të ofroj validitetin e ofertës së tij prej 90 ditë, andaj sukurse eksperti shqyrtues edhe Paneli Shqyrtues konstaton se OE ankuesi ofertën e tij e ka në kundërshtim me kushtet e AK. OE ankues ka qenë dashtë që këtë çështje apo dilemë ta sqarojë para ofertimit të tij/saj me AK, sepse këtë e lejojnë dispozitat ligjore. Vlen të theksohet se këtë kërkesë e kanë respektuar të gjithë OE tjerë pjesëmarrës të cilët validitetin e ofertave e kanë sjellë konform kërkesave të Njoftimit për Kontratë pra prej 120 ditëve, përveç ankuesit në këtë rast prej 90 ditëve.

Ankuesi ka ngritur edhe pretendime tjera ankimore ndaj OE të rekomanduar për kontratë, ku OE i rekomanduar ka plotësuar një formë tjetër të kontratave të realizuara sipas kërkesave të DT-së, por jo edhe sipas formës së kërkuar të Aneksi 6, OE ankues në listën e dorëzuar ka përfshirë të gjitha të dhënat e tjera të kërkuara përmes Aneksi 6, përveç pjesës ku deklaroi se- “Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të verifikojë të dhënat e paraqitura në këtë Aneks dhe nëse vërtetohet ndonjë dëshmi e rreme, oferta e tillë do të konsiderohet si një oferte e pa përgjegjshme dhe për shkak të paraqitjes së të dhënave të rreme, do të kërkohej nga Organi Shqyrtues i Prokurimit për të vënë atë në listën e zezë të Operatoreve Ekonomik.” Kjo pjesë e Aneksi 6 nuk është përfshirë në listën e dorëzuar me ofertë nga ana e OE i rekomanduar, i cili bënë që kjo listë sipas ekspertit të mos mund të konsiderohet si dokument i përpiluar sipas kërkesave të DT-së. OE i rekomanduar është dashur të plotësoj Aneksi 6 sipas DT-së, duke shtuar apo hequr rreshta sipas nevojës, duke nënshkruar dhe vulosur të njëjtën formë të kërkuar. Paneli Shqyrtues konsideron se një OE nuk mund të eliminohet vetëm se ka përdorur një formë tjetër të listës e cila është komplet konform kërkesa të Ankesit 6, e cila është e nënshkruar dhe e vulosur dhe ka të bashknagjitura kontrat dhe referencat të cilat sipas AK janë vlerësuar se janë konform DT, ky vlerësim i panelit shqyrtues vjen edhe duke u nisur nga neni 10 nga Udhëzuesit nr. 001/2023 për Prokurim Publik, ngase i rekomanduar posedon kontrata e realizuara të cilat kanë qenë kërkesë e Dosjes së Tenderit. Kurdo herë nëse AK dyshon për ndonjë dokument apo të dhënë të

rreme mund të vë në funksion nenin 52.7 të LPP. Por edhe secila palë mundet me ju drejtuar organeve të rendit të cilat janë kompetente për këto çështje.

Ankuesi ka ngritur edhe pretendime tjera ankimore ndaj OE të rekomanduar për kontratë, ku OE i rekomanduar në ofertën e dorëzuar për stafin profesional të angazhuar, si dëshmi e këtij stafi në DT është kërkuar që të dorëzohen edhe kontratat e punës me punëdhënësin ose marrëveshje mbi angazhimin për këtë projekt. OE i rekomanduar në ofertën e tij, përveç emërimit të menaxherit të projektit i cila është emëruar me vendim, për të gjithë stafin tjetër të përfshirë në listë, ka dorëzuar kontratat tre vjeçare të punës të lidhura me këta inxhinier, por eksperti pasqyron që këto kontrata janë lidhur në vitin 2022 që do të thotë që do të përfundojnë në vitin 2025, ndërsa aktiviteti i prokurimit ka kohëzgjatja tre vjeçare përkatësisht deri në vitin 2027. Në këtë pikë, vlerësoj se OE i rekomanduar është dashur të dorëzoj marrëveshje për angazhim të stafit apo kontrata me një periudhë e cila përfshinë edhe realizimin e të gjithë projektit. Megjithatë konsideroj që operatori ekonomik ka përmbushur kriterin e kontratave të punës me punëdhënësin dhe të njëjtat janë dorëzuar edhe në ofertë. Paneli Shqyrtues njëjtë sikurse eksperti shqyrtues konsideron se OE i rekomanduar për kontratë ka plotësuar kërkesën e AK dhe kjo nuk paraqet bazë për eliminimin e tij, për shkak se kontratat kurdoherë mund të vazhdohen apo/ri-përtrihen.

Paneli shqyrtues për pjesën e pretendimeve tjera ndaj OE të rekomanduar për kontratë e mbështet ekspertin, pa nevoj që të njëjta të përsëriten prap, ndërsa, për pretendimeve ndaj OE tjerë pjesëmarrës nuk do të lëshohet në shqyrtim të tyre për shkak se nuk ka ndryshim të vendimit të AK, ngase, Paneli shqyrtues vendos ti jep të drejtë AK dhe që ta lë në fuqi vendimin e AK, vendim ky i cili është nxjerrë nga një komision i vlerësimit i cili supozohet të jetë profesional dhe po ashtu përgjegjës sipas nenit 59.1 cituar Të gjithë anëtarët e Komisionit Vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin e kryer të ofertës, rrjedhimisht pasi që Paneli shqyrtues ka konstatuar ashtu sikurse AK, se ankuesi është i papërgjegjshëm (eliminuar) si dhe në bazë të vendimit të AK edhe letrave standarde edhe OE tjerë pjesëmarrës janë të eliminuar dhe nuk kanë parashtruar ankesë (që d.t.th janë pajtuar me eliminimin e tyre), atëherë në zbatim të nenit 1 të LPP-së dhe me qëllim që mos ta prolongohet ky aktivitet të prokurimit edhe më tutje dhe pa ndonjë arsye konkrete dhe në mungesë të ndonjë argumenti bindës se OE i rekomanduar mund të jetë i papërgjegjshëm, atëherë paneli vlerëson se është në përgjegjësi të AK edhe përzgjedhja e OE të rekomanduar për kontratë.

Paneli Shqyrtues thekson se secili autoritet kontraktues (në nivelin qendror dhe lokal) gëzon autonomi në planifikimin e prokurimit (neni 8) dhe në përcaktimin e nevojave që duhen përmbushur (neni 9), natyrisht ne pajtim me kapacitetin buxhetor dhe se AK në rastin konkret ka pasur të drejtë të vendos po ashtu edhe për OE të rekomanduar për dhënie të kontratës bazuar edhe në neni 24 paragrafi 2 të LPP cituar "Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj".

Kthimi i një aktivitetit të prokurimit pa bazë kontestuese ligjore në ri-vlerësim, nuk është në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: "...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji".

Prandaj duke vepruar mbi bazën e parimeve themelore të procedurave për shqyrtimin e prokurimit, të cilat mes tjerash, janë sanksionuar në mënyrë të veçantë me dispozitën e nenit 104, të LPP dhe njëherësh duke i analizuar shkresat e kësaj lënde në relacion me faktet dhe rrethanat e

përshkruara si më sipër, e posaçërisht duke i kushtuar kujdesin e duhur po ashtu dhe natyrës dhe qëllimit të pretendimeve ankimore, Paneli Shqyrtues mori në konsideratë të gjitha pohimet e ankuesit, aktet dhe veprimet e ndërmarra nga AK, raportin e ekspertit shqyrtues dhe i analizoi me kujdes të gjitha shkresat e kësaj lënde dhe konsideron se pohimi ankimor i OE ankues është i pabazuar dhe refuzohet, ashtu siç janë dhënë në konstatimet e panelit.

Paneli shqyrtues në këtë vendim marrje ka pasur në konsideratë edhe kërkesat e nenit 104, paragrafi 4 të LPP, sipas të OSHP duhet të veprojë sa më shpejtë që të jetë e mundshme, të veprojë në mënyrë proporcionale me shkeljen e pretenduar ose çështjen për të cilën është paraqitur ankesa, dhe të marrë për bazë pasojat e mundshme të veprimeve ose masave në të gjitha interesat që mund të dëmtohen, duke përfshirë interesin publik.

Andaj, duke vepruar në pajtim me kompetencat e cituara si më sipër dhe nenin 104 paragrafi 4 lidhur me paragrafin 1, sipas të cilit procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e ligjshme dhe efektive të lëndës, si dhe duke ju referuar nenit 117 të LPP-së, dhe në provat e prezantuara si më lartë Paneli Shqyrtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues
Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KOMUNA E VUSHTRRIË**
- **OE - AI Group PRO SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: